



Sugjerime dhe truke për temën...

Loja

Për fëmijët jeta fillon me lojën.

Loja

Për fëmijët jeta fillon me lojën. Një pjesë e mirë e zhvillimit mendor dhe fizik bëhet përmes lojës. Loja e përbashkët me të tjerë i nxit kompetencat gjuhësore, sociale dhe kulturore. Fëmijët mësojnë si në lojën e lirë, ashtu edhe në lojën e udhëzuar. Të dyja duhet të japin kënaqësi!

Ju mund të bëni këtë:

- Luani së bashku me fëmijën tuaj, kjo e forcon lidhjen:
 - p.sh. loje ku fshihni, 'Gugus dada'...
 - p.sh. lojë konstruksioni, me kube, Lego, punë dore, edhe me të ashtuquajtur material pa vlerë si boçe të bredhit, karton, ...
 - p.sh. jashtë, në kopösht, në pyll, në përrua...
 - p.sh. lojë me rregulla, lojë me zare, memory, lojë me letra
- Krijoni një ambient stimulues, në të cilin fëmija juaj të mund të zhvillojë dhe realizojë ide për lojëra.
- Siguroni që fëmija juaj të ketë kohë, hapësirë dhe qetësi, që ai të mund të thellohet në lojë.
- Mundësoni që fëmija juaj të luajë me fëmijë të tjerë. Ftoni shokë të tjerë të lojës në shtëpi, shkoni në fusha të lojërave.
- Ofrojini fëmijës suaj nëpërmjet vizitës së grupeve të lojës, gjimnastikë-nënë-fëmijë mundësi të shumëllojshme të kontaktit.
- Materiale të lojës duhet të jenë të përshtatshme me moshën dhe zhvillimin dhe nuk duhet të mbingacmojnë fëmija juaj. Edhe sende prej jetës së përditshme mund të jenë pajisje për të luajtur, p.sh. enë, litarë, kapëse rrobash, tenxhere...

Meqë ra fjala:

Gëzimi në lojën e përbashkët është baza e zhvillimit.

Früherziehungsdienst des Kantons Bern FED

Geschäftsstelle, Frankenstrasse 1, 3018 Bern

Telefon 031 869 18 78, info@fed-be.ch, www.fed-be.ch